

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i krimeve të rënda, kolegji penal i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, gjyqtarët Fllanza Kadiu dhe Mejreme Memaj, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.R. nga D, për shkak të veprës penale Sulm seksual parashikuar me nenin 232 par.1 të KPRK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesat e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës avokatit Q.N.dhe mbrojtësit të akuzuarit avokatit B.M., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë. P.nr.373/2013 datë 11.09.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24 Dhjetor 2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Sipas ankesave të përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës, avokatit Q.N.dhe mbrojtësit të akuzuarit avokatit B.M. edhe detyrimisht ndaj të akuzuarit M.R., për veprën penale për të cilën është shpall fajtor, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.373/2013 datë 11.09.2014, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin M.R. me të dhëna personale si në shkresat e lëndës, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPP

LIROHET NGA AKUZA

Se më datë 28.10.2013 në Malishevë, ka prek personin tjetër me qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 12,15 minuta, i akuzuari R, e merr të dëmtuarën P.O. e moshës mbi 16 vjeçare e lindur më 20.03.1997 dhe e dërgon në dyqanin e këpucëve ” ”...”” pronë e M.R. nga B., i cili më parë ia jep çelësat e lokalit të akuzuarit, i cili me të hyrë në lokal s’bashku me të dëmtuarën e mitur e ka mbyllur me qelës, derën e dyqanit nga ana e brendshme dhe menjëherë të dëmtuarës X. ia ka hjekë rrobat nga trupi, përkatësisht pantallonat ia zbrit nën gjunjë, e shtrinë në një krevat të improvizuar dhe më pas e puth atë në pjesë të ndryshme të trupit duke e ledhatuar e krejt këtë me qëllim seksual, ashtu që me të kuptuar nga ana e policisë se i pandehuri gjendet në lokal me një vajzë, shkojnë në vendin e ngjarjes dhe të pandehurin e arrestojnë

- me çka i akuzuari kishte për të kryer veprën penale Sulmi Seksual parashikuar me nenin 232 par.1 të KPRK

Në bazë të nenit 454 par.1 të KPP gjykata cakton se shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin i ngarkohen mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Pala e dëmtuar X. M. nga ..., përmes përfaqësuesit ligjor udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesave pasurore juridike.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gj, me aktgjykimin P.nr.373/2013 datë 11.09.2014, të akuzuarin M.R., e ka shpallur fajtor për veprën Sulm seksual parashikuar me nenin 232 par.1 të KPRK-ës, për të cilën vepër penale e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj e në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 28.10.2013 e deri më 20.05.2014. I akuzuari është obliguar të paguaj paushallin gjyqësor prej 200 €, ndërsa e dëmtuara përmes përfaqësuesit ligjor është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesave pasurore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë ushtruar:

- përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës avokati Q.N, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe të kthehet në rigjykim apo të ndryshohet ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i rëndë - maksimumi i dënimit.

- mbrojtësi i të akuzuarit, avokati M.B nga V., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet e kthehet në rigjykim ose të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Prokurorisë së Apelit të Kosovës, me parashtresën PPAM/I nr.97/14 datë 21.11.2014 mbështeti në tersi ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit duke propozuar të aprovohet në tersi ankesa, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP për seancën e kolegjit janë informuar Prokurori i Apelit i akuzuari me mbrojtësin, përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës. Në seancë nuk morën pjesë Prokurori i Apelit i cili është njoftua me rregull ndërsa përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës ka njoftuar gjykatën se për shkaqe objektive nuk do të merr pjesë në seancë. Prokurori edhe pse nuk mori pjesë në seancë në parashtresën PPAM/I nr.97/14 datë 21.11.2014 dërguar kësaj gjykate ka mbështetur në tërësi ankesën e

përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës duke propozuar të aprovohet në tërësi kjo ankesë ndërsa ajo e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar. Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarës i ati N.V.në tërësi mbështeti ankesën e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe propozimin e Prokurorit të Apelit. Mbrojtësi i të akuzuarit avokati B.M., pasi që sqaroi disa nga pretendimet ankimore të ankesës me shkrim ngeli në tërësi pran të njëjtës ndërsa i akuzuari i mbështeti këto pretendime ankimore.

Gjykata Apelit në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPP, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale vlerësoi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësimi të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se duhet vepruar si në dispozitiv.

Sipas shkresave të çështjes, pra aktakuzës së ndryshuar në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor të datës 11.09.2014 dhe aktgjykimit të kundërshtuar rezulton se i akuzuari M.R. është akuzuar për veprën penale Sulmi seksual parashikuar me nenin 232 par 1 të KPRK me këtë përshkrim të aktakuzës ” sepse i akuzuari më datë 28.10.2013 në ..., ka prek personin tjetër me qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 12,15 minuta, i akuzuari e merr të dëmtuarën P.O. e moshës mbi 16 vjeçare e lindur më 20.03.1997 dhe e dërgon në dyqanin e këpucëve ”Ideal” pronë e M.R, i cili më parë ia jep çelësat e lokalit të akuzuarit, i cili me të hyrë në lokal s bashku me të dëmtuarën e mitur e ka mbyllur me qelës, derën e dyqanit nga ana e brendshme dhe menjëherë të dëmtuarës X. ia ka hjekë rrobat nga trupi, përkatësisht pantallonat ia zbrit nën gjunjë, e shtrinë në një krevat të improvizuar dhe më pas e puth atë në pjesë të ndryshme të trupit, duke e ledhatuar e krejt këtë me qëllim seksual, ashtu që me të kuptuar nga policia se i pandehuri me një vajzë gjendet në lokal, shkojnë në vendin e ngjarjes dhe të pandehurin e arrestojnë”. Në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor Prokurori ndryshon përmbajtjen e aktakuzës fillestare ashtu që nga përshkrimi i përmbajtjes së dispozitivit të aktakuzës, heq rrethanat kualifikuese (se i akuzuari kishte qenë person zyrtar, mësimdhënës, ndërsa e dëmtuara person e cila kishte mbush moshën 16 vjeçe). Pra në fjalën e fundit nga emërtimi ligjor i veprës penale Sulmi seksual nga neni 232 par.3 nënparagrafi 3.10 lidhur me par.2 nënparagrafi 2.3 të KPRK, të akuzuarin e akuzon se ka kryer të njëjtën veprë penale pa format kualifikuese e për të cilën veprë penale Gjykata e shkallës së parë e shpallë të akuzuarin fajtor.

Kështu sipas ligjit vepra penale Sulmi seksual parashikuar me nenin 232 par.1 të KPRK-ës përcakton: “Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet”. Nga përkufizimi i kësaj vepre penale themelore, rezulton se është veprë e përbërë dhe përbëhet nga prekja e personit tjetër me qëllim seksual pa pëlqimin e këtij personi tjetër (viktimit). Pra, një nga elementet konstituive të kësaj vepre penale është se këto prekje bëhen “pa pëlqimin e personit tjetër”. Ndërsa ligjvënësi në dispozitën e nenit 228 par.1 të KPRK (e cila shpjegon kuptimin e shprehjeve të përdorura në kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual) ka shpjeguar se shprehja “pëlqim”

nënkupton pajtimin e vullnetshëm të personit i cili ka mbushur moshën 16 vjeçe. Ndërsa me nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të të njëjtit nen ka përcaktuar se rastet kur te personi i tillë (viktima) nuk ekziston pëlqimi, pra kur viktima mbi 16 vjeçe, me fjalë ose me sjellje shprehë mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë, se pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës, pajtimi i viktimës është marr me mashtrim, frikësim ose me kërcënim ose mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës..., ose viktima është e paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike... Duke u gjendur në praninë e kësaj rrethane, Gjykata Apelit gjen se në veprimet e të akuzuarit M.R. të përshkruara në dispozitiv të aktit akuzues të ndryshuar në fjalën përfundimtare e as të aktgjykimit të kundërshtuar nuk qëndrojnë të gjitha elementet konstituive të veprës penale të Sulmi seksual i parashikuar me nenin 232 par.1 të KPRK sepse vepra penale për të cilën u shpallë fajtor ekziston vetëm kur prekja seksuale e personit tjetër (i cili ka mbush moshën 16 vjeçe) kryhet pa pëlqimin e këtij personi tjetër, pra viktimës e cila ka mbush moshën 16 vjeçe.

Kjo gjykatë vlerëson se nuk është e mjaftueshme (siç është përshkruar në dispozitiv të akuzës e edhe në atë aktgjykimit të kundërshtuar) vetëm të thuhet se i akuzuari e ka prek të dëmtuarën me qëllim seksual pa pëlqimin e saj, pa konkretizuar mënyrën apo sjelljet e të dëmtuarës 16 vjeçe se si u manifestua ky mospëlqim i saj ashtu siç shpjegohet e kërkohet me dispozitën e nenit 228 par.1 nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK. Prokurori në akuzë e edhe gjykata në dispozitiv të aktgjykimit ka pas obligim të vej në dukje të faktet dhe rrethanat të shprehjes “mospëlqim” të personit mbi moshën 16 vjeçe, që paraqesin elemente të veprës penale.

Nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese të akuzuarit në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar përveç se që përshkruhet se i akuzuari e ka prek të dëmtuarën për qëllime seksuale nuk u përshkruan rrethanat të cilat tregonin se te dëmtuara e moshës 16 vjeçe, nuk ka ekzistuar pëlqimi për këto prekje seksuale, pa të cilin fakt vendimtar nuk mund të vërtetohet edhe fakti kontestues se kishte Sulm seksual nga neni 232 par.1 i KPRK, pra nga e gjithë kjo rrjedh se në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar ashtu siç është përshkruar e bënë të paqartë dhe të papërshtatshëm për vlerësim pasi qëndron një konfuzitet i lartë në aspektin juridik e që i shkojnë në favor të akuzuarit meqë prokurori nuk ka arritur të bëjë aktakuzë të mirëfilltë në bazë të nenit 241 par.1 nënp.1.4 e 1.5 të KPP e gjykata e shkallës së parë në bazë të kësaj akuze e ka shpall fajtor edhe pse në bazë të nenit 365 par.1 nëpar.1.1 të KPP i akuzuari shpallet fajtor për veprën penale s bashku me rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të kundërshtuar ka dhënë arsye se ka ekzistuar sulmi seksual nga neni 232 par.1 të KPRK, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se mungesa e përshkrimit të fakteve dhe rrethanave që përbëjnë figurën e veprës penale në dispozitiv të akuzës (të cilën prokurori nuk e ka përmirësuar në fjalën e tij të fundit e as që ka ushtruar fare ankesë kundër aktgjykimit), e meqë në bazë të nenit 360 të KPP “aktgjykimi mund ti

referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës së paraqitur...” arsyetojnë që në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPP ndaj të akuzuarit të merret aktgjykim lirues pasi që rrethanat e cekura më lartë kushtëzojnë të konkludohet se vepra penale me të cilën i akuzuari është akuzuar nuk përmban vepër penale.

Meqë i akuzuari u lirua nga akuza, shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës(nenit 454 par.1 të KPP).

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiviv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.569/14, më 24 Dhjetor 2014

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi, _____

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro _____

Anëtarët e kolegjit:

1. Fllanza Kadiu _____

2. Mejreme Memaj _____